



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES
KËSHILLI I BASHKISE



V E N D I M

Nr. 06, datë 24.01.2020

Për miratimin e rinovimit të kontratës së dhënies me qira të fondit pyjor për antene të telefonisë celulare subjektit “ALBtelekom” sh. a.

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 24.01.2020, me propozim të Kryetarit së Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “e”, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore neni 19 pika 1 e ligjit nr. 9385 date 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor“ i ndryshuar” pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, Këshilli pas miratimit me shumice të cilësuar votash:

V E N D O S I

1. Miratimin e rinovimit të kontratës për dhënie me qira sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë **nr.105,date 24.12.2018** për ngastrën nr .13 Ekonomia pyjore Bushat Berdice me sipërfaqe **0.03 ha** për antene për komunikime elektronike,publike,telefoni celulare, si dhe rrugë kalimi me gjatësi 0.311 km nga Subjektit “**ALBtelekom**” sh a.sipas raportit teknik,relacionit dhe hartës bashkëlidhur.
2. Afati i dhënies me qera të jetë 1 vjeçar.
3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas studimit tekniko-ekonomik bashkëlidhur, sipas VKM, Nr. 1064, dt. 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.
4. Ngarkohet Drejtoria e Pyjeve,Turizmit,Kulturës dhe Mjedisit , Sektori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave për zbatimin e vendimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,i ndryshuar.
6. Ky vendim u shpall sot me datën 31.01.2020



SEKRETARI
Ardian Celepija

KRYETARI
Mark Bisha